

Data 26/09/2025

**PROCESVERBAL – TIPI KONTRATËS – SHËRBIME
(PROCEDURË E HAPUR, MBI KUFIRIN E LARTË MONETAR)
PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Mirëmbajtja korigjuese dhe parandaluese e impiantit fotovoltaiik në digën e Qyrsaqit për një periudhë 2 vjeçare”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Shërbime të tjera -98390000-3.

VLERA E FONDIT LIMIT: 40,000,000 (Dyzet milion) Lekë pa TVSH ose 413,137 (Katërqind e trembëdhjetë mijë e njëqind e tridhjetë e shtatë) Euro pa TVSH.

Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datë 26/09/2025 është 96.82 Lekë/Euro.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Korporata Elektroenergjiike Shqiptare**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10.*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi:

Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës” të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i ndryshuar. Në Nenin 83 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar citohet: “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP i ndryshuar.

“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet Kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale : me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës Nr. 10.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP i ndryshuar, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se dyfishi i vlerës së përllogaritur të kontratës.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e LPP i ndryshuar, si dhe nenin 43 pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në dispozitat e legjislacionit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar. VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike". Duke marrë në konsideratë specifikën e objektit procedurë prokurimi, kërkohet që Operatorët Ekonomik ofertues të paraqesin vërtetime të cilat vërtetojnë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për të realizuar këtë procedurë prokurimi në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 39 % vlerës së përllogaritur të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi:

Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, pika 3, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 39 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, sipas formatit të miratuar me VKM nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi., ku të përfshihen të paktën kategoria e mëposhtme:

 **NP 10 – A** Ndërtimi i impianteve për prodhimin e energjisë elektrike.

Argumentimi:

Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/a, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku AK mund të kërkojë licenca profesionale për realizimin e shërbimeve objekt i kontratës të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

Në kuadër të zbatimit për punimet e rikostruksionit dhe mirëmbajtjes së impiantit PV Qyrmaq, është e nevojshme që të kriteret e prokurimit, shoqëria duhet të disponojë licencë të vlefshme në zbatimin e punimeve, konkretisht pika NP-10.

Arsyeja e vendosjes se kriterit mbi disponimin e licencës në zbatim është nga nevoja e llojit të punimeve që do të kryhen pasi në objekt kemi të bëjmë me rikonstruksion metalik të strukturës mbajtëse të paneleve si dhe të inverterave, punime elektrike në anën DC të impiantit, si dhe mirëmbajtja e impiantit në vazhdimësi.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij minimalisht :

-  1 (një) inxhinier elektrik,
-  1 (një) inxhinier elektronik
-  1 (një) inxhinier mekanik.

Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklaramit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklaramit si:

-  Kontratë pune të vlefshme;
-  Diplomat përkatëse;
-  Listëpagesat e shoqërisë formulari E-sig, për periudhën Korrik 2025 - Shtator 2025.

Argumentimi:

Kërkesat për punonjësit, janë kërkuar në bazë të pikës 4, të nenit të 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/b të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku me anë të këtij kriteri vërtetohet që operatorët ekonomikë dëshmojnë se kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit. KESH sh.a, duhet të ketë besueshmërinë dhe të kërkojë garanci për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi, duke përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar.

Konkretisht:

Inxhinier elektrik:

Referuar kërkesave të AK-së të paraqitura në termat e referencave inxhinieri elektrik është thelbësor për analizimin dhe projektimin e impianteve elektrike. Siguron që instalimet të jenë sipas standardeve të sigurisë (IEC/EN), do të kryejë mbikëqyrjen dhe riparimet në inverter, kabllime DC/AC, sistemet e mbrojtjes dhe pajisjet e shpërndarjes së energjisë. Gjithashtu inxhinieri elektrik është i nevojshëm për diagnostikimin e defekteve elektrike, dhe do të jetë pjesë ndihmëse në testimin dhe kolaudimin e impiantit para vënies në punë.

Inxhinier elektronik:

Referuar kërkesave të AK-së të paraqitura në termat e referencave inxhinieri elektronik është i nevojshëm për diagnostifikimin e defekteve të inverterëve, moduleve të kontrollit, sensorëve dhe pajisjeve elektronike. Siguron mirëfunksionimin e sistemeve të monitorimit dhe komunikimit (p.sh. lidhje me SCADA). Do të jetë pjesë mbështetëse për riparimet e qarqeve elektronike dhe pajisjeve të kontroll monitorimit.

Inxhinier mekanik:

Referuar kërkesave të AK-së të paraqitura në termat e referencave inxhinieri mekanik do të kujdeset për strukturat mbajtëse të paneleve, montimin e paneleve si dhe elementët mekanikë të fiksimit. Siguron stabilitetin e impiantit ndaj ngarkesave të erës, reshjeve, apo faktorëve të tjerë mekanikë. Gjithashtu gjatë mirëmbajtjes, kontrollon korrozionin, fiksimit dhe integritetin e bazamenteve.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij minimalisht personelin teknik :

-  1 (një) teknik elektrik të trajnuar për PV;
-  2 (dy) teknik elektrik;
-  1 (një) teknik mekanik;
-  1 (një) specialist për sigurinë dhe shëndetin në punë (HSE);

Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklaramit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklaramit si:

-  Kontratë pune të vlefshme;
-  Certifikata profesionale përkatëse, lëshuar nga institucionet e autorizuar me ligj.
-  Listëpagesat e shoqërisë formulari E-sig, për periudhën Korrik 2025 - Shtator 2025;

Argumentimi:

Kërkesat për punonjësit, janë kërkuar në bazë të pikës 4, të nenit të 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/b të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku me anë të këtij kriteri vërtetohet që operatorët ekonomikë dëshmojnë se kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit. KESH sh.a, duhet të ketë besueshmërinë dhe të kërkojë garanci për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi, duke përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar.

Konkretisht:

Teknik elektrik i trajnuar për PV: Referuar kërkesave të AK-së të paraqitura në termat e referencave tekniku elektrik i trajnuar për PV , është thelbësor pasi ka ekspertizë specifike për montimin, testimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve PV, gjithashtu është i nevojshëm për kryerjen e shërbimeve të lidhjes së DC/AC, tokëzimet dhe standardet e sigurisë për energjinë diellore.

Teknik elektrik: Referuar kërkesave të AK-së të paraqitura në termat e referencave teknikët elektrik janë të nevojshëm për realizimin e punimeve praktike të lidhjeve, instalimeve dhe testeve elektrike nën mbikëqyrjen e inxhinierit. Si dhe do të jenë përgjegjës për inspektimet rutinë, matjet, etj.

Teknikë mekanikë: Referuar kërkesave të AK-së të paraqitura në termat e referencave tekniku mekanik do të kryej montimin dhe mirëmbajtjen e strukturave, ankorimeve dhe elementëve mbajtës. Si dhe do të kryej inspektime të përditshme për stabilitetin e strukturës dhe pastrimin mekanik të paneleve.

Specialist për sigurinë dhe shëndetin në punë (HSE). Referuar kërkesave të AK-së të paraqitura në termat e referencave specialisti për sigurinë dhe shëndetin në punë është i domosdoshëm për të garantuar që punimet kryhen në kusht sigurie, sidomos pasi kemi të bëjmë me energji elektrike në tension dhe punë në lartësi. Gjithashtu harton dhe zbaton planin e menaxhimit të rreziqeve gjatë riparimeve dhe mirëmbajtjes si dhe Siguron pajisjet mbrojtëse personale (PPE) dhe trajnimin e stafit.

2.3.5 Operatori Ekonomik duhet të vërtetojë se disponon minimalisht 1 (një) specialist të certifikuar për sistemet SCADA, i cili mund të jetë pjesë e stafit të operatorit ekonomik ose i kontraktuar me anë të një marrëveshjeje.

Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklaramit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklaramit si:

-  Kontratë pune të vlefshme / kontratë marrëveshjeje bashkëpunimi të vlefshme, e cila të ketë një afat jo më pak se afati i marrëveshjes kuadër;
-  Çertifikatën profesionale përkatëse, lëshuar nga institucionet e autorizuar me ligj.
-  Listëpagesat e shoqërisë formulari E-sig, për periudhën Korrik 2025 - Shtator 2025 në rastin nëse specialisti do të jetë pjesë e stafit të operatorit ekonomik;

Argumentimi:

Kërkesat për punonjësit, janë kërkuar në bazë të pikës 4, të nenit të 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/b të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku me anë të këtij kriteri vërtetohet që operatorët ekonomikë dëshmojnë se kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit. KESH sh.a, duhet të ketë besueshmërinë dhe të kërkojë garanci për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi, duke përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar.

Konkretisht:

Specialist i certifikuar SCADA: ky specialist është kërkuar pasi Impiantet PV janë të pajisur me sisteme SCADA për monitorim dhe kontroll në kohë reale. Për rrjedhojë specialisti i certifikuar për sistemet SCADA është i nevojshëm për: Integrimin e inverterave të rinj në qendrën e kontroll-monitorimit, konfigurimin e komunikimeve dhe softuerit të monitorimit, diagnozën e problemeve të telemetrisë dhe automatizimit. Pra garantohet mbikëqyrja e vazhdueshme e performancës së impiantit.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë Çertifikatat **ose ekuivalentet e tyre**, në përputhje me objektin e prokurimit, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:

-  ISO 9001- “Sistemi i menaxhimit të cilësisë”;
-  ISO 45001- “Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë”;
-  ISO 50001- “Sistemi i menaxhimit të energjisë”;
-  ISO 14001- “Sistemi i menaxhimit të mjedisit”;

ISO 9001: “Sistemi i menaxhimit të cilësisë” - Ky standard është i nevojshëm për çertifikimin në realizimin e cilësisë, identifikimin e rrisqeve, caktimin e burimeve të nevojshme për të kontrolluar nëse mallrat e ofruar janë të cilësisë së duhur si dhe kontrollin e proceseve.

ISO 45001: “Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë” - Ky standart është i nevojshëm për ndërgjegjësimin e gjithë personelit të shoqërisë në lidhje me masat e mbrojtjes së shëndetit, sigurisë dhe konsultimit të punësuarve për vlerësimin e rrisqeve të shëndetit dhe sigurisë në punë.

ISO 50001- “Sistemi i menaxhimit të energjisë” – Ky standard është i nevojshëm për stimulimin e kontraktorëve për të gjetur mënyra në identifikimin e mundësive për të reduktuar konsumin e energjisë, duke konsideruar përfshirjen e stafit në këtë proces

ISO 14001 – “Sistemi i menaxhimit të mjedisit” – Ky standard është i nevojshëm për stimulimin e kontraktorëve për të gjetur mënyra në identifikimin e mundësive për të reduktuar ndikimin mjedisor dhe konsumin e burimeve natyrore, duke konsideruar përfshirjen e stafit në këtë proces.

Argumentimi:

Kërkesa në lidhje me këto certifikata është në përputhje me nenin 44 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe nenin 79 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizimin e prodhuesit/ve ose distributoreve të autorizuar për mallrat të cilat do të furnizohen dhe zëvendësohen në përputhje me Termat e Referencës dhe Specifikimet Teknike:

Zëri nr 1 – Inverter 27 Kw, 3Ph.

Zëri nr 3 – Module fotovoltaike, 480Wp dhe 485 Wp Monocristaline.

Dokumentacioni duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit.

Argumentimi:

Kriteri i mësipërm është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenin 41, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Kërkesa për paraqitjen e autorizimeve të prodhuesve ose distributorëve është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallrave na garanton se Operatori ekonomik ofertues është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të pjesëve/mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në përputhje me standardet. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-së për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3.8 Operatori ekonomik në lidhje me mallrat objekt prokurimi që do të përdoren gjatë realizimit të shërbimeve, duhet të paraqesë deklaratë se janë të certifikuara me certifikate konformiteti ose cilësie CE/ekuivalent.

Argumentimi:

Kriteri i mësipërm është në përputhje me nenin 77 të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, si dhe në nenin 40 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Ky kriter ka për qëllim garantimin e cilësisë dhe sigurisë së mallrave të ofruara, duke u siguruar se ato përmbushin standardet e kërkuara . Kjo masë mbrohet Autoritetin Kontraktor nga furnizimi me produkte nën standard dhe siguron që kontrata të përmbushet në përputhje me kërkesat ligjore dhe teknike.

Shënim: Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Në rast të ofertave nga ofertues të huaj, dokumentet e ofertës duhet të jenë ekuivalente me dokumentet e kërkuara sipas parashikimeve ligjore të fushës për njehsimin e dokumenteve.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

Hartimi i specifikimeve teknike është bërë në përputhje të plotë me standardet dhe kushtet teknike shqiptare (SSH) si dhe ato ndërkombëtare (IEC/EN). Të gjitha kërkesat për mirëmbajtjen korrigjuese dhe atë periodike janë përcaktuar me qëllim përmbushjen e objektit të procedurës së prokurimit, që është rikthimi i impiantit në gjendje pune me kapacitet të plotë dhe sigurimi i funksionimit të pandërprerë në vazhdimësi.

Specifikimet teknike të pajisjeve janë hartuar duke u bazuar në projektin e ndërtimit të impiantit fotovoltaik, me qëllim garantimin e përputhshmërisë së plotë të pajisjeve që do të zëvendësohen me sistemin ekzistues. Për të siguruar një inspektim të specializuar lidhur me gjendjen teknike të impiantit fotovoltaik, në specifikime është parashikuar që operatori ekonomik të kryejë inspektimin dhe të përcaktojë nevojat konkrete për riparime, zëvendësime dhe ndërhyrje të tjera të nevojshme.

Njësia e Prokurimit